

REPUBLIKA SHQIPËRISË

“ETiX Audit & Consultancy” Sh.p.k.

Rruga “Muhamet Gjollësia, Njësia Administrative nr. 7,

Zona Kadastrale 8250, Nd.2/834-ND, Tiranë

NIPT: M41910016M

KONTRATË TRANSFERIMI KUOTASH

(DHURIM)

Sot, më datë 11/07/2024, në Tiranë në ambjentet e selisë së Shoqërisë “ETiX Audit & Consultancy” Sh.p.k. nënshkruhet kjo kontratë transferimi për dhurim kuotash në prezencë të palëve si më poshtë:

PALËT KONTRAKTUESE:

DHURUESI

- **Z. Elton Tirana**, shtetas Shqiptar, lindur më 24.02.1974, në Tiranë dhe banues në Rr. “Medar Shtylla”, Nd.47, Ap.8, Tiranë, identifikuar me Nr. Personal H40224146M, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

PËRFITUESI

- **Znj. Tiziana Xholi**, shtetase Shqiptare, lindur më 24.06.1987, në Durrës dhe banuese në Rr. “Irfan Tomini”, Nd.1844, Ap.135, Tiranë, identifikuar me Nr. Personal I75624085G, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- Shoqëria “ETiX Audit & Consultancy” Sh.p.k. është regjistruar si person juridik pranë QKB-së më datë 10.07.2024, me NIPT M41910016M, me kapital themeltar me vlerë 100,000 Lekë (Njëqind mijë), aktualisht me status aktiv.
- Kuotat e Shoqërisë “ETiX Audit & Consultancy” Sh.p.k. zotërohen nga palët si vijon:
 - Znj. Tiziana Xholi, zotëruese e një kuote, të cilës i korrespondon 50% e vlerës së kapitalit të shoqërisë, me vlerë 50.000 (Pesëdhjetë mijë) Lekë;
 - Z. Elton Tirana, zotërues i një kuote, të cilës i korrespondon 50% e vlerës së kapitalit të shoqërisë, me vlerë 50.000 (Pesëdhjetë mijë) Lekë.
- Me Vendimin Nr. 1/2024 e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë është miratuar transferimi i kuotave me dhurim nga ortaku z. Elton Tirana në favor të znj. Tiziana Xholi.

OBJEKTI I KONTRATËS

Pala dhuruese, z. Elton Tirana, i dhuron me vullnet të lirë palës pranuese, znj. Tiziana Xholi, 1% të kuotave të kapitalit themeltar që zotëron në Shoqërinë “ETiX Audit & Consultancy” Sh.p.k., e barabartë me vlerën 1,000 (Njëmijë) Lekë.

Pala pranuese, znj. Tiziana Xholi, me vullnet të lirë dhe të plotë i pranon palës dhuruese, z. Elton Tirana, 1% të kuotave që zotëron në kapitalin themeltar, e barabartë në vlerë me 1,000 (njëmijë) Lekë.

TRANSFERIMI I PRONËSISË

Me nënshkrimin e kontratës së transferimit (dhurimit) të kuotave të cituara më lart, pala dhuruese zhvishet nga 1% e kapitalit zotërues, e barabartë në vlerë me 1,000 (njëmijë) Lekë që gëzon në Shoqëri duke kaluar në zotërim të pjesës prej 49%, e barabartë me vlerën 49,000 (dyzet e nëntë mijë) Lekë, dhe pala pranuese bëhet zotëruese e pjesës së dhuruar prej 1% të kapitalit themeltar duke kaluar në zotërim të pjesës prej 51%, e barabartë me vlerën e 51,000 (pesëdhjetë e një mijë) Lekë.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, ortakët e Shoqërisë "ETiX Audit & Consultancy" Sh.p.k. paraqiten si më poshtë:

- 1. Znj. Tiziana Xholi:** zotëruese e një kuote, të cilës i korespondon 51% e vlerës së kapitalit të Shoqërisë me vlerë 51,000 (Pesëdhjetë e një mijë) Lekë;
- 2. Z. Elton Tirana:** zotërues i një kuote, të cilës i korespondon 49% të kapitalit të Shoqërisë me vlerë 49,000 (Dyzet e nëntë mijë) Lekë.

DEKLARIME TË PALËVE

Pala dhuruese deklaron dhe garanton palën pranuese se 1% e pjesës zotëruese në Shoqërinë "ETiX Audit & Consultancy" Sh.p.k. që i transferohen pales pranuese, janë të lira nga çdo barrë apo e drejtë juridike apo monetare dhe janë menjëherë lirisht të transferueshme.

Pala pranuese deklaron se e pranon transferimin e 1% të pjesës zotëruese nga kapitali i Shoqërisë "ETiX Audit & Consultancy" Sh.p.k. në favor të vet duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet që do të burojnë nga kjo pjesë kuote e lindur nga momenti i nënshkrimit të kontratës.


DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Kontrata u përpilua në 4 (katër) kopje me fuqi të barabartë, njëra prej të cilave depozitohet në regjistrin tregtar duke u bërë shënimet për ndryshimet përkatëse

PALËT KONTRAKTUESE

PALA DHURUESE

Elton Tirana



PALA PRANUESE

Tiziana Xholi

